



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 114

Tiranë – E mërkurë, 22 qershor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 441, datë 15.6.2016	Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes së lejes së qëndrimit për të huajt..... 8129
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 442, datë 15.6.2016	Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes së dokumentit të udhëtimit për personat pa shtetësi dhe lejes së kalimit për të huajt.... 8131
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 444, datë 15.6.2016	Për kalimin në pronësi të Bashkisë Kukës, për Njësinë Admini- strative Shishtavec, të pronës me emërtimin “Posta e Policisë Kufitare Novosej”, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar... 8133
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 445, datë 15.6.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 591, datë 10.9.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit të veprimit për përmirësimin dhe monitorimin e indikatorëve “Të bësh biznes””..... 8134
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 446, datë 15.6.2016	Për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale..... 8140
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 447, datë 15.6.2016	Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1481, datë 12.11.2008; nr. 1657, datë 24.12.2008; nr. 100, datë 27.1.2009; nr. 167, datë 19.2.2009; nr. 286, datë 18.3.2009; nr. 450, datë 6.5.2009; nr. 611, datë 11.6.2009; nr. 677, datë 18.6.2009; nr. 706, datë 23.6.2009; nr. 805, datë 22.7.2009; nr. 1038, datë 14.10.2009; nr. 1134, datë 18.11.2009; nr. 1283, datë 23.12.2009; nr. 125, datë 17.2.2010; nr. 247, datë 13.4.2010; nr. 404, datë 26.5.2010; nr. 549, datë 7.7.2010, nr. 646, datë 28.7.2010; nr. 118, datë 17.2.2011; nr. 359, datë 4.5.2011; nr. 822, datë 23.11.2011; nr. 513, datë 1.8.2012; nr. 345; datë 24.4.2013; nr. 501, datë 10.6.2015; nr. 42, datë 21.1.2015; nr. 279, datë 1.4.2015; nr. 474, datë 3.6.2015; nr. 615, datë 7.7.2015; nr. 669, datë 29.7.2015; nr. 823, datë 7.10.2015; nr. 882, datë 30.10.2015, për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale, të ndryshuara..... 8157

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 449, datë 15.6.2016	Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike.....	8169
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 450, datë 15.6.2016	Për emërimin në detyrë të administratorit të shoqërisë “Nxitja e biznesit social” sh.a.....	8171
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 451, datë 15.6.2016	Për transferimin në pronësi, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror të Bashkia Poliçan, të qendrës polivalente për shërbime të përkujdesit shoqëror, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 1324, datë 1.10.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, të ndërtesës së ish-Spitalit, Poliçan, dhe një ndryshim në vendimin nr. 60, datë 1.2.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror”.....	8171
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 453, datë 15.6.2016	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Bulqizë-Ura e Çereneçit”.....	8175
Urdhër i ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 5091, datë 21.6.2016	Për miratimin e formularit të aplikimit dhe procedurave për përfitimin e mbështetjes financiare lidhur me projektet për turizmin..	8176

**VENDIM¹****Nr. 441, datë 15.6.2016**

**PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE TË
PËRMBAJTJES SË LEJES SË QËNDRIMIT
PËR TË HUAJT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 33, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Punëve Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e formës dhe të përmbajtjes së lejes së qëndrimit për të huajt, sipas anekseve 1 dhe 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Vendimi nr. 469, datë 6.5.2009, i Këshillit të Ministrave, “Për caktimin e elementeve të sigurisë dhe për miratimin e formës e të modelit të lejes së qëndrimit për shtetasit e huaj”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

ANEKS 1

**ELEMENTET E SIGURISË SË LEJES SË
QËNDRIMIT PËR TË HUAJT**

**I. PËRSHKRIMI I LEJES SË QËNDRIMIT
PËR TË HUAJT**

Leja e qëndrimit për të huajt do të jetë në formën e kartës biometrike. Ky dokument përfshin të dhënat biometrike të mbajtësit dhe do të prodhohet si një kartë “*smart*” hibride, me dy *chipe* të ndryshme: me kontakt dhe pa kontakt.

Përmbajtja elektronike e *chipe*-ve përfshin këto aplikime:

- *Chipi*, me kontakt (*Contact Chip*):
- aplikimi Java;
- aplikimi ID;
- aplikimi PKI;
- aplikimi, krahasim në kartë.

- *Chipi* pa kontakt (*Contactless Chip*)

- aplikimi ICAO

**II. ELEMENTET E SIGURISË SË LEJES SË
QËNDRIMIT PËR TË HUAJT**

1. Materiali

Materiali i kartës, në përputhje me standardet ICAO 9303 dhe ISO 7810, duhet të plotësojë minimalisht këto kërkesa:

- Polycarbonate;
- Jetëgjatësi max. 10 vite;
- Trupi i kartës të jetë UV Dull.

2. Teknika të printimit

Gjatë procesit të printimit do të aplikohen këto teknika:

- OVI Printing;
- Microtext;
- Kinegram;
- Line Structures;
- Guilloches.

Të gjitha elementet e sigurisë që do të përdoren në printimin e kartës në zona të caktuara do të kenë një pamje uniforme.

3. Mbrojtja kundër kopjimit

Një element OVD (Kinegramë) do të aplikohet në faqen e parme të kartës, duke u trupëzuar në strukturën e saj, duke na dhënë kështu një nivel të lartë sigurie kundër kopjimit.

4. Teknika e personalizimit

Për t'u siguruar që të dhënat e personalizuara në kartën e lejes së qëndrimit janë të sigurta kundër orvatjeve për ta falsifikuar, të dhënat biografike, përfshirë dhe fotografinë e mbajtësit, si dhe të dhënat e tjera të lejes së qëndrimit, do të integrohen me tej në materialin bazë të kartës, nëpërmjet procesit të personalizimit (lëshimit). Teknika që do të përdoret për këtë qëllim do të jetë “*laser engraving*”.

ANEKS 2

**FORMA DHE MODELI I LEJES SË
QËNDRIMIT PËR TË HUAJT**

I. TRUPI I LEJES SË QËNDRIMIT

Karta biometrike “Leje qëndrimi” në formatin D1 përbëhet nga shtresa të ndryshme prej materiali “*polycarbonat*”. Procesi i laminimit do ta bëjë trupin e kartës njësh e të pandashëm.

Dimensionet e kartës biometrike “Leje qëndrimi” janë në përputhje me specifikimet ISO 7810, me dimensionet, si vijon:

- Gjerësia:

¹ Ky vendim është përfuar plotësisht me rregulloren e Këshillit të Evropian (KE) nr. 1030/2002, datë 13 qershor 2002, “Mbi përcaktimin e formës uniforme të lejeve të qëndrimit për shtetasit e vendeve të treta”, e ndryshuar, Numri CELEX 32002R1030, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 157, datë 15.6.2002, faqe 1–7.

Min. 85.47 mm;

Max. 85.72mm.

– Lartësia:

Min. 53.93 mm;

Max. 54.04 mm.

– Të katër qoshet e harkuara me rreze:

$r = 2.88$

$r = 3.48$ mm (ISO 7813)

II. PËRMBAJTJA E LEJES SË QËNDRIMIT PËR TË HUAJT

Trupi i kartave biometrike “Leje qëndrimi”

është i përbërë nga material “*policarbonat*” dhe pamja e dy faqeve është si në fig. 1 dhe fig. 2.

Të gjitha të dhënat, si: portreti (1), nënshkrimi (2), imazhi ghost (3) dhe të dhënat alfanumerike (4) printohen me teknologji *laser engraving*.

Në faqen e prapme të kartës biometrike “Leje qëndrimi” printohet shiriti MRZ (në format 3 rreshta) sipas standardeve ICAO (5).

Fig. 1. Faqja e përparme



Fig. 2. Faqja e prapme



**VENDIM****Nr. 442, datë 15.6.2016****PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE TË PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT PËR PERSONAT PA SHTETËSI DHE LEJES SË KALIMIT PËR TË HUAJT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 8, dhe 17, pika 3, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Modeli dhe specifikimet e dokumentit të udhëtimit për personat pa shtetësi janë të njëjta me modelin e dokumentit të udhëtimit për refugjatët, të parashikuar në ligjin nr. 10322, datë 23.9.2010, “Për ratifikimin e shtesës së kontratës koncesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike”, ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe grupimit të “Sagem Securite” dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”.

2. Miratimin e specifikimeve teknike të dokumentit të udhëtimit “Pasaportë për personat pa shtetësi”, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Miratimin e specifikimeve teknike për dokumentin “Leje kalimi për shtetas të huaj”, sipas aneksit 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Miratimin e modelit për dokumentin “Leje kalimi për shtetas të huaj”, sipas aneksit 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1**SPECIFIKIME TEKNIKE TË DOKUMENTIT TË UDHËTIMIT “PASAPORTË PËR PERSONAT PA SHTETËSI”**

- Dokumenti i udhëtimit “Pasaportë për personat pa shtetësi” do të jetë me përmasa 125x88 mm, me qoshe të rrumbullakëta dhe do të ketë 50 faqe (përfshijë kapakët).

- Kapaku i dokumentit të udhëtimit për personat pa shtetësi do të jetë me ngjyrë blu.

- Në faqen ballore të kapakut të dokumentit, në pjesën e sipërme të saj do të shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze “REPUBLIKA E SHQIPËRISË/REPUBLIC OF ALBANIA”

- Në faqen ballore të kapakut të dokumentit, në pjesën e mesit do të vendoset emblema e Republikës së Shqipërisë.

- Në faqen ballore të kapakut, në pjesën e poshtme dhe në faqen e parë të fletës së personalizuar do të shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: DOKUMENT UDHËTIMI PËR PERSONAT PA SHTETËSI (Konventa e 28 shtatorit 1954)/TRAVEL DOCUMENT (Convention of 28 september, 1954).

- Në faqen e përparme të të dhënave do të shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: “Republika e Shqipërisë/Republic of Albania”; në mes të saj do të shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: “Dokument udhëtimi (Konventa e shtatorit 1954) /Travel Document (28 september 1954 Convention)”; në pjesën e poshtme të saj do të shkruhet në gjuhën shqipe dhe angleze: “Ky dokument përmban 50 faqe./This document contains 50 pages”.

- Në faqen e të dhënave mbi fotografinë e aplikuesit do të shkruhet në ngjyrë të bardhë dhe sfond blu, në gjuhën shqipe dhe angleze: “DOKUMENT UDHËTIMI / TRAVEL DOCUMENT”.

- Në faqen e të dhënave, tipi i dokumentit do të jetë ‘PT’. Autoriteti lëshues do të jetë MPB (Ministria e Punëve të Brendshme) dhe fillimi i zonës së lexueshme nga makina (MRZ) do të fillojë me ‘PT’ në vend të ‘P’ që vendoset në pasaportat normale shqiptare.

- Kodi 3-shifror do të zëvendësohet me kodin kombëtar të transmetuar nga RKGJC për të huajt pa shtetësi.



Shënim.

- Dokumenti i udhëtimit për personat pa shtetësi në pjesët e tjera të saj do të jetë i njëjtë me pasaportën biometrike për refugjatët.

ANEKSI 2

SPECIFIKIME TEKNIKE PËR DOKUMENTIN LEJE KALIMI PËR SHTETAS TË HUAJ

- Leja e kalimit për shtetasit e huaj do të jetë letër në përmasat 210X297 (format A4).

- Pesha specifike e letres që do të përdoret për leje kalimi do të jetë 100–120 g/m².

- Dokumenti “Leje kalimi për të huajt” do të përmbajë këto elemente sigurie:

- shtyp me bojë të padukshme (të dukshme vetëm nën veprimin e dritës UV).

- numri i serisë 7-shifror me bojë fluore-shente.

Leja e kalimit për të huajt do të ketë përmbajtjen, si formati në vijim:

Aneks 3

ALBANIA

**LEJE KALIMI
VETËM PËR NJË UDHËTIM**

**LAISSEZ PASSER
FOR A SINGLE JOURNEY ONLY**

No. XXXXXXX
 Autoriteti lëshues _____
 Issuing authority
 Mbiemri _____
 Family name
 Emri/at _____
 Given Names
 Shtetësia e mbajtësit _____
 Citizenship of bearer
 Datëlindja _____
 Date of Birth
 Gjinia _____ Vendlindja _____
 Sex _____ Place of Birth

Fotografia
Photograph

Ky dokument është i vlefshëm vetëm për një udhëtim nga: _____
 në: _____
 This document is valid for a single journey only as from: _____ (Shtetit /State)
 to _____ (Shtetit /State)

Nënshkrimi i mbajtësit/ Signature of bearer

Lëshuar në _____ më _____
 Issuedat _____ (Vendi/Place) on _____ (data/date)

Nënshkrimi i Nëpunësit Lëshues
Signature of issuing Officer

Rezervuar për VIZE / Reserved for VISA

Ky dokument është pronë e shtetit shqiptar
 Autoritetet aeroportuale të vendeve transite janë të lutur
 të asistojnë personin e interesuar gjatë procedurave të
 kalimit transitit, nëse është e nevojshme.

This document is property of Albanian State
 The transit airport authorities are pleased to assist, if
 necessary, the interested person during the transit
 procedures.



VENDIM
Nr. 444, datë 15.6.2016

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË
BASHKISË KUKËS, PËR NJËSINË
ADMINISTRATIVE SHISHTAVEC, TË
PRONËS ME EMËRTIMIN “POSTA E
POLICISË KUFITARE NOVOSEJ”, DHE
PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 250, DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
RENDIT PUBLIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “j”, 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Kukës, për njësinë administrative Shishtavec, të pronës “Posta e Policisë Kufitare Novosej”, me vendndodhje në zonën kadastrale 2812, me sipërfaqe 2 800 (dy mijë e tetëqind) m² dhe nr. rendor 58–63, sipas formu-

larit bashkëlidhur, për t’u përdorur për funksione publike dhe zhvillimin e turizmit.

2. Në listën e inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar, hiqet prona me emërtimin “Posta e Policisë Kufitare Novosej”, me nr. rendor 58–63.

3. Prona e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Bashkisë Kukës, për njësinë administrative Shishtavec, që i bashkëlidhet vendimit nr. 458, datë 6.5.2009, të Këshillit të Ministrave.

4. Bashkisë Kukës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

5. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, kryetari i Bashkisë Kukës dhe kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

3.FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

Institucioni / Pushtetit Qendror MRP (Drejtoria Policise se Qarkut Kukës)				Identifikoi :		Grupi i Punes				
Bashkia / Komuna Shishtavec				Supervizoi:		Shef.Sek.Administrim Prones Y.Myslimaj				
Fusha e përdorimit te Prones :Ruajtje Rendi						Spec. Ing.L. Shkupi		Spec. Ing.A. Hallvaxhiu		
				Miratoi :		Ministri i Rendit Publik Z. Luan Rama				

Nr. Ren	A		Emertesa e prones Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike	Komponentet Perberes te Prones	Adresa/vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e prones ne m2 ose mi	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
	Zona Kadast Indeks Hartes	Nr. Pasurise								
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
			P.Policise Kufitare Borje		Truall Total	9858				Ardhur me shkresen Nr.458 Dt.29.07.2002
44				Godina kryesore		345	Zyra	MRP	Dr.Pol.Qark.Kukes	E demtuar
45				Banese familjare		170	Banese	MRP	Dr.Pol.Qark.Kukes	E demtuar
46				Depo		12	Depo mallrash	MRP	Dr.Pol.Qark.Kukes	E demtuar
47				Tualet,lavanteri		15	Tualet	MRP	Dr.Pol.Qark.Kukes	E demtuar
48				Stalle		50	Stalle bagetish	MRP	Dr.Pol.Qark.Kukes	E demtuar
49				Kashun qeni		12	Kashun qeni	MRP	Dr.Pol.Qark.Kukes	E demtuar
50										
51			P.Policise Kufitare Shishtavec		Truall Total	11447				
52				Godina kryesore	Pike referimi	343	Zyra	MRP	Dr.Pol.Qark.Kukes	Funksionon
53				Banese familjare		170	Banese	MRP	Dr.Pol.Qark.Kukes	E demtuar
54				Depo	Afer god.kryesore	12	Depo mallrash	MRP	Dr.Pol.Qark.Kukes	Funksionon
55				Tualet,lavanteri	Jug-Lindje	30	Tualet	MRP	Dr.Pol.Qark.Kukes	E demtuar
56				Stalle	Jug-Lindje	250	Stalle bagetish	MRP	Dr.Pol.Qark.Kukes	E demtuar
57				Kashun qeni	Veri-Perendim	6	Kashun qeni	MRP	Dr.Pol.Qark.Kukes	E demtuar
58			P.Policise Kufitare Novosej		Truall Total	2800				
59				Godina kryesore	Pike referimi	281	Zyra	MRP	Dr.Pol.Qark.Kukes	E demtuar
60				Banese familjare	Jug-Lindje	184	Banese	MRP	Dr.Pol.Qark.Kukes	E demtuar
61				Depo	Veri	105	Depo mallrash	MRP	Dr.Pol.Qark.Kukes	E demtuar
62				Tualet,lavanteri	Veri	6	Tualet	MRP	Dr.Pol.Qark.Kukes	E demtuar
63				Stalle	Veri	31	Stalle bagetish	MRP	Dr.Pol.Qark.Kukes	E demtuar

**VENDIM****Nr. 445, datë 15.6.2016**

**PËR DISA SHTESA DHE
NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 591,
DATË 10.9.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
PLANIT TË VEPRIMIT PËR
PËRMIRËSIMIN DHE MONITORIMIN
E INDIKATORËVE “TË BËSH
BIZNES””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në planin e veprimit për përmirësimin dhe monitorimin e indikatorëve “Të bësh biznes”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 591, datë 10.9.2014, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**



PLANI I VEPRIMIT PËR PËRMIRËSIMIN E LEHTËSIRAVE TË TË BËRIT BIZNES

Rekomandimi	Masa e propozuar	Afati i zbatimit	Institucioni përgjegjës	Rezultati i pritshëm	Komente/status
Hapja e një biznesi					
Unifikimi i procedurave të regjistrimit në Inspektoratin e Punës dhe Zyra e Taksave të Bashkisë. Ulja e kostos së fillimit të biznesit.	Miratimi i ligjit “Për nxitjen e punësimit” me synim eliminimin e detyrimit për regjistrimin e punonjësve në zyrat e punësimit	Tremujori II 2016	MMSR	Janë përcaktuar të drejtat e punëdhënësve, duke i konsideruar si një proces bashkëpunimi dhe jo detyrimesh të njëanshme nga ana e punëdhënësve.	
	Ndryshimi i VKB-së së Tiranës nr. 3, datë 5.02.2007, i ndryshuar	Tremujori II 2016	Bashkia Tiranë	Pagesa e taksave lokale për bizneset e posa regjistruara të behet të paktën 3 muaj pas fillimit të aktivitetit	
Konsolidimi i procedurave të regjistrimit dhe licencimit	Hartëzimi i procedurave dhe proceseve për regjistrimin dhe licencimin	30 korrik 2016	MZHETTS/QKB		
	Vlerësimi i procedurave dhe proceseve për regjistrimin dhe licencimin dhe propozimi i rekomandimeve	30 shtator 2016			
	Draftimi i ndryshimeve ligjore, përfshirë edhe aktet nënligjore përkatëse.	Dhjetor 2016			
Reduktimi i kërkesave për leje dhe licenca	Rishikimi i licencave dhe lejeve me synim evidentimin e licencave dhe lejeve të panevojshme si dhe thjeshtësimin e procedurave respektive	30 dhjetor 2016	MZHETTS/QKB		Referuar strategjisë së Zhvillimit të bizneseve dhe investimeve është përcaktuar reduktimi i numrit të ditëve për hapjen e një biznesi të ri për vitin 2016 në 3 ditë dhe në vitin 2017 në 2 ditë, si dhe reduktimi i numrit të procedurave për hapjen e një biznesi të ri për vitin 2016 në 3 ditë dhe në vitin 2017 në 2 ditë
	Hartimi i raportit me gjetjet kryesore dhe nevojat për ndryshime ligjore	30 qershor 2017			
	Hartimi i raportit të monitorimit	Dhjetor 2017			



Lejet e ndërtimit					
Ulja e kohës për marrjen e Certifikatës së Pronësisë	Monitorimi i respektimit nga Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme i afateve të përcaktuara në urdhrin e Kryeregjistruesit nr. 995, datë 31.10.2014 “Për përcaktimin e afateve të trajtimit dhe përpunimit të kërkesave” për sa i takon lëshimit të Certifikatës së Pronësisë.	Në vijimësi	ZRPP		
Minimizimi i kohës për inspektim në terren nga një ekspert i autorizuar dhe marrja e miratimit (30 ditë) dhe reformimi i sistemit të inspektimeve, ndërsa ndërtimi është në vazhdim, etj.	Propozimi nga MZHU për ndryshimin e ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”	Tremujori II 2016	MZHU		
Minimizimi i kohës dhe koston për të marrë lejen e zhvillimit të ndërtimit (45 ditë).	Ministorimi i respektimit të afatit për lëshimin e lejeve nga pushteti vendor: • Bashkitë mund të lëshojnë leje zhvillimi brenda 10 ditësh në përputhje me nenin 9 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, e ndryshuar • Është shkurtuar afati i lejes së ndërtimit me vendimin nr. 271, datë 6.4.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit”	Në vijimësi	MZHU	Shkurtimi i afatit për marrjen e lejeve të ndërtimit	Është shkurtuar afati i lejes së ndërtimit me Vendimin Nr. 271, datë 06.04.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit”
Minimizimi i kohës dhe i ditëve të nevojshme për të marrë lejen e shfrytëzimit (30 ditë) dhe regjistrimin të magazinave (45 ditë).			MZHU		Është vendosur afati 30 ditë për marrjen e Certifikatës së Përdorimit me vendimin nr. 271, datë 6.4.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit”
Saktësim dhe thjeshtim i dokumentacionit të kërkuar për leje ndërtimit, sipas nenit 15, germa “g”), e rregullores së zhvillimit të territorit dhe procedurave			MZHU		Është shkurtuar afati i lejes së ndërtimit me ndryshimin nëpërmjet ndryshimit të VKM nr. 408 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"



Marrja e energjisë					
Lehtësimi i procedurave dhe reduktimi kohës për marrjen e lidhjes së re për biznesin	Hartimi i rregullores së re të lidhjeve të reja në zbatim të ligjit për sektorin elektrik	Tremujori II 2016	MEI ERE	Shkurtimi i procedurave dhe kohës për lidhjet e reja	
Regjistrimi i pasurisë					
Reduktimi i kohës për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe transaksioneve mbi këto pasuri për t'a përputhur me afatet e përcaktuara në udhëzimin e Kryeregjistruesit nr. 995, datë 31. 10. 2014 "Për përcaktimin e afateve të trajtimit dhe përpunimit të kërkesave"	Bazuar në udhëzimin e përbashkët ZRPP dhe Dhoma e Noterëve nr. 285/1, datë 19. 01. 2016 procesi i kalimit të pronësisë do të bëhet nëpërmjet noterëve, i cili do të verifikojë on-line statusin e pasurisë dhe do të kryejë aplikimet online për 27 shërbime që ofron ZRPP	Në vijimësi	ZRPP	Uljen e kohës dhe procedurave të verifikimit të statusit të pronësisë	
Përmirësimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave elektronike të regjistrimit të pasurive të paluajtshme duke saktësuar kufijtë dhe pozicionin gjeografik të çdo parcele (Sistemi Informativ Gjeografik)	Zhvillimi i një Plani Veprimi për përmirësimin/përditësimin e të dhënave dixhitale të pasurive të paluajtshme në Qarkun e Tiranës. Garantimi i fondeve / burimeve njerëzore të nevojshme	Tremujori II 2016	ZRPP	Te gjitha të dhënat do të përmirësohen/përditësohen në format dixhital	
	Përfundimi i procesit të përmirësim/përditësimit të të dhënave dixhitale të pasurive të paluajtshme në ZVRPP Tiranë.	30 maj 2017			
Marrja e kredisë					
Përmirësimi i indeksit të thellësisë së informacionit të kreditorëve	Përfshirja në raportimin e bërë pranë Regjistrat të Kredive nga institucionet e kreditit (Bankat, IFJB, SHKK-të) edhe i të dhënave për kreditë: • në proces gjyqësor; • e ristrukturuara; • e shitura	Tremujori II 2016	BSH	Plotësimi i të dhënave për profilin e rrezikut të kredimarrësve	
Krijimi e një sistemi të ri Regjistri Kredie për ofrimin e Pikësimit të Kreditit (Credit Scoring)	Rishikimi i termave të referencës për ofrimin e Pikësimit të Kreditit (Credit Scoring) nga Regjistri i Kredisë	30 dhjetor 2017	BSH dhe Institucione të tjera	Ofrimi i Pikësimit të Kreditit (Credit Scoring) nga Regjistri i Kredisë	
Përmirësimi i indeksit për të	Amendimi i ligjit nr. 8537, datë 18.10.1999 Për barrët	Tremujori	MZHE/TTS	Përmirësimi i indeksit për	Miratuar nga KM-ja



drejtat ligjore për marrjen e kredisë	siguruese	II 2016		të drejtat ligjore për marrjen e kredisë	
	Miratimi nga Kuvendi i Amendimit të ligjit nr. 8537, datë 18.10.1999 Për barrët siguruese	30 shtator 2016			
Vlerësimi i kuadrit ligjor lidhur me financimet e siguruara mbi pasuritë e luajtshme të paprekshme dhe nëse është e nevojshme, përgatitja e rekomandimeve përkatëse ligjore me qëllim shmangien e mbivendosjeve apo keqinterpretimeve ligjore.	Ngritja e një grupi të përbashkët pune me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe palëve të interesuara	30 qershor 2016	MZHETTS	Përmirësim i mëtejshëm i indeksit për të drejtat ligjore për marrjen e kredisë dhe thjeshtësimi i referimeve ligjore lidhur me financimet e siguruara	
	Kryerja e një analize të kuadrit ligjor mbi mangësitë, mbivendosjet, apo kundërshtitë ligjore	30 maj 2017	MZHETTS dhe grupi i punës		
	Përgatitja e një raporti me gjetjet dhe rekomandimet sipas rastit	30 qershor 2017	MZHETTS dhe grupi i punës		
Pagesa e taksave					
Pagimi elektronik i taksave me qëllim uljen e kohës dhe numrit të pagesave të taksave	Ndërhyrja e DPT për të bërë rregullimet e nevojshme në sistemin informatik me qëllim kryerjen brenda një kohe sa më të shkurtër pagesa elektronike e tatimeve.	Shtator 2017	DPT	Reduktimi i numrit të pagesave dhe zvogëlim i kohës për kryerjen e pagesave	Implementimi i sistemit të ri ka diktuar edhe ndryshime të rëndësishme në sistemin e deklarimit dhe të pagesave të detyrimeve tatimore.
	Krijimi i mundësive të deklarimit tatimor nëpërmjet ofrimit të shërbimit pa pagesë për biznesin nëpërmjet krijimit të zyrave të shërbimit pranë zonave me densitet të lartë biznesi.	Shtator 2017	DPT		
	Krijimi i një portali funksional ku biznesi të marrë përgjigje zyrtare për procedurat e deklarimit dhe interpretimin e legjislacionit tatimor dhe mundësimin e shërbimeve që lidhen me procedurat e deklarimit qarkullimit shkresor ,vërtetime të ndryshme për situatën e detyrimeve, debite etj.	Shtator 2017	DPT		
Tregtia përmes kufijve					
Krijimi i lehtësive tregtare për biznesin	Futjen e menaxhimit të rrezikut në Agjencinë Shqiptare për Sigurinë Ushqimore dhe zhvillimi i metodologjisë së menaxhimit të bazës së të dhënave dhe mjetet për Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	Dhjetor 2016	MBZHRAU		



	Thjeshtimin i masave sanitare dhe fitosanitare	Dhjetor 2017	MBZHRAU/AKU		
	Miratimi i udhëzimit të ministrit të Financave për zbatimin e AEO;	Qershor 2017	MF/DPD		
	Rritja e kapaciteteve të administratës doganore për të zbatuar praktikën AEO dhe ndërlidhja me praktikat më të mira në rajon	Qershor 2016-2017	DPD		Ky aktivitet do të jetë i vazhdueshëm
	Hartimi i një udhëzimi të ri lidhur me procedurat që do të ndiqen për peshimin	Tetor 2016	DPD	• Ulja e kohës së kryerjes së procedurave për eksport • Ulja e kohës së procedurave për eksport	
	Ndryshimi i udhëzimit të ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar “ për të hequr “urdhrin e çlirimit” si dokument shoqërues që kërkohet në import.	Tremujori II 2016	MF	• Ulet numri i dokumenteve të kërkuara në import, përmirësim në renditje	
Zgjidhja e paaftësisë paguese					
Përmirësimi i pjesëmarrjes së kreditorëve gjatë procedurës së falimentimit	Ligji i ri “Për falimentimin”	Tremujori II 2016	Ministria e Drejtësisë		

**VENDIM****Nr. 446, datë 15.6.2016****PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË
PRONËSISË SË DISA PARCELAVE
NDËRTIMORE NË FAVOR TË
POSEDUESVE TË OBJEKTEVE
INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, të shkronjës “ç”, të nenit 4, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar, dhe të nenit 163, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqet maksimale, për të cilat miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën e ndërtimit pa leje, të jenë sipas listës emërore dhe evidencës që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Numri i parcelave ndërtimore dhe sipërfaqja e përgjithshme e truallit për secilin qark janë, si më poshtë vijon:

a) Qarku Tiranë, 315 (treqind e pesëmbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 92 721 (nëntëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e njëzet e një) m²;

b) Qarku Elbasan, 80 (tetëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 23 542 (njëzet e tre mijë e pesëqind e dyzet e dy) m²;

c) Qarku Fier, 19 (nëntëmbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 5 648 (pesë mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) m²;

ç) Qarku Gjirokastrë, 39 (tridhjetë e nëntë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 12 022 (dymbëdhjetë mijë e njëzet e dy) m²;

d) Qarku Vlorë, 1 (një) parcelë ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 333 (treqind e tridhjetë e tre) m²;

dh) Qarku Berat, 23 (njëzet e tre) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 5 179

(pesë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë) m²;

e) Qarku Kukës, 30 (tridhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 8 216 (tetë mijë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë) m²;

ë) Qarku Korçë, 21 (njëzet e një) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 2 563 (dy mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) m²;

f) Qarku Lushnjë, 11 (njëmbëdhjetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 4 382 (katër mijë e treqind tetëdhjetë e dy) m²;

g) Qarku Lezhë, 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 19 075 (nëntëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e pesë) m²;

gj) Qarku Shkodër, 4 (katër) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 1 839 (një mijë e tetëqind tridhjetë e nëntë) m²;

h) Qarku Dibër, 38 (tridhjetë e tetë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 10 285 (dhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) m²;

i) Qarku Durrës, 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 58 791 (pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e një) m².

3. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelave ndërtimore, të objekteve informale, nga shteti te poseduesit e ndërtimeve pa leje.

4. Deri në momentin e regjistrimit të ndërtimit të legalizuar, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të mos kryejnë ndryshime të gjendjes juridike të pasurive të listuara në këtë vendim.

5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**



**AGJENCIA E LEGALIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE/NDËRTIMEVE INFORMALE TË DHËNAT SIPAS LISTËS
EMËRORE PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË**

Nr. Rendor	DREJTORIA	Të dhënat e vetëdeklaruesit				Zona Kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja e parçelës m²	Lloji I pronesisë
		Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. i prot. te vetëdeklarimit				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	13
1	ELBASAN	BESJON	QAMIL	TAFANI	239, 3521	1147	275/59	126.1	Pronar
2	ELBASAN	DRITAN	SELMAN	TABAKU	16901	8522	6/276	116.6	Prona + Shtet
3	ELBASAN	ERMELINDA	ISMET	GJETA					
4	ELBASAN	HASAN	SOKOL	BARJA	8452	8522	9/467	336.9	Shtet
5	ELBASAN	GENTIAN	BAJRAM	METALLA	20330	8522	12/340	283.8	Shtet
6	ELBASAN	YLLI	HASIM	DUZHA	1195, 9188	8524	2/664	135.5	Shtet
7	ELBASAN	NIKOLLA	NAUN	HAILI	301, 5577	8525	10/210	193.5	Shtet
8	ELBASAN	LIRIKA	TOLI	HAILI					
9	ELBASAN	ILIA	RIFAT	FIRAKU	605, 7538	8525	13/275	375.9	Shtet
10	ELBASAN	SONILA	QERIM	FIRAKU					
11	ELBASAN	HAXHI	AHMET	XIBRAKU	5296	8525	16/221	300	Shtet
12	ELBASAN	TEFTA	QAMIL	TAFANI	17629	8525	17/109	187.5	Shtet
13	ELBASAN	EDUART	JUSUF	SADIKAJ	111, 1085	8526	7/149	350.1	Shtet
14	ELBASAN	FATMIR	RYZHDI	ÇARKU	1629	8526	16/94	245.6	Shtet
15	ELBASAN	AVNI	RUSTEM	CËRRIKU	425, 9350	8526	314/20/2	262.24	Pronar
16	ELBASAN	REFAT	ISMAIL	ÇEKA	247, 6210	8526	2276/3/1	213	Pronar
17	ELBASAN	AMDI	BEKTASH	TRËNDAFI	987, 5808	8527	11/121	199.4	Pronar
18	ELBASAN	ILIR	XHEVIT	BAHA	15622	8527	11/125	268.1	Pronar
19	ELBASAN	LUMNI	HYSEN	MULLISI	18, 4801	8527	13/27	121.2	Shtet
20	ELBASAN	DASHAMIR	ALI	ÇILI	1151, 11085	8527	162/101	352.5	Pronar
21	ELBASAN	JETON	BARDHYL	SALLA	348	2654	1276/1	290.1	Shtet
22	ELBASAN	LUTFI	ILMI	ADEMI	3735	1785	2099/1	230	Shtet
23	ELBASAN	AFRIM	HAMDI	KOVAÇI	1231	2446	2/131/1	20.2	Shtet
24	ELBASAN	YLBER	SHAQIR	JUGU	1126	2446	2/189	117.9	Shtet
25	ELBASAN	PETRIT	HAXHI	HASANAJ	940, 1145, 8078	2446	2/214	291	Shtet
26	ELBASAN	REXHEP	HAJDAR	KOJKU	1308	2446	6/132/2	42.5	Shtet
27	ELBASAN	AGIM	MUHAMET	XHANI	14000	2446	6/440	329.1	Shtet
28	ELBASAN	AZEM	RYZHDI	MUZHAKI	644	2446	10/283/1	6	Shtet
29	ELBASAN	SADIK	HYSEN	BIÇAKU	1425, 6175	2448	234/2/2	111.9	Shtet
30	ELBASAN	NAILE	HALIL	MËNALLA	13902	2696	252/1	270	Shtet
31	ELBASAN	FATOS	XHEVAT	GURRA	285	2924	1/1/1	293.1	Shtet
32	ELBASAN	ARTUR	HEKURAN	MARA	217	2924	1/482	187.5	Shtet
33	ELBASAN	HYSEN	ISUF	QYTYKU	5796	2924	1/117/2	115.9	Shtet
34	ELBASAN	SEFE	HAKI	PAJA	227, 21999	2924	2/489	62	Pronar
35		MBARESA	ZYLIF	PAJA					
36		ARJAN	REXHEP	TOPI					
37		SUZANA	SKËNDER	TOPI	231				
38		DALIP	SELIM	LUKA					
39	ELBASAN	XHANE	BEQIR	LUKA	219, 21995				
40	ELBASAN	PERPARIM	RASIP	KOKONOZI	347	2925	64/1/1	257.1	Shtet
41	ELBASAN	ÇELNIK	SHABAN	CANI	299	3203	1032/1/2	291	Shtet
42	ELBASAN	PAJTIM	ZENEL	ÇOLLARI	130	3683	32/2	474.8	Shtet
43	ELBASAN	SHABAN	IDRIS	BALLA	18	3683	94/3	479.7	Shtet
44	ELBASAN	RASIP	ALUSH	TOÇKA	5780	3683	139/1	432	Shtet
45	ELBASAN	XHEVAT	ABDULLA	TOÇKA	52/1	3683	139/4	464.7	Shtet
46	ELBASAN	NEZIR	RAMAZAN	ZITO	132	2116	172/5	333.3	Shtet
47	ELBASAN	LUTFI	SELAMI	GOLEMI	160/2	2248	380/2	295.2	Shtet
48	ELBASAN	DURIM	SKËNDER	RADIÇI	20917	2096	377/2/1	256.8	Pronar
49	ELBASAN	HALIT	ISUF	ZHARRI	22260	1905	45/1	395.4	Shtet
50	ELBASAN	ISLAM	SEFER	SHEBEGU	21187	2970	720/1	427.8	Shtet
51	ELBASAN	QAZIM	ISMAIL	BEQIRI	283, 17476	3120	212/1	270	Shtet
52	ELBASAN	RENATO	GURIM	KURTI	18165	1365	42/12/1	499.9	Shtet
53	ELBASAN	ALUSH	XHAFERR	SALLA	3355	2892	611/15	395	Shtet
54	ELBASAN	DRITAN	ALUSH	SALLA					
55	ELBASAN	FAIK	LIMAN	ZHARRI	1462, 21205	2924	1/474	146	Prona e vet + Shtet
56	ELBASAN	DORIAN	NAMIK	BYLYKBASHI	273, 5359	8521	5/8/1	62.43	Shtet
57	ELBASAN	PETRIT	SHEFQET	ÇEKOJA	1556	8521	16/462	30	Shtet
58	ELBASAN	NIKOLLA	VASIL	BEKO	11	8522	7/105/1	140.3	Pronar
59	ELBASAN	FATIME	ZEQIR	TRIMI	7231	8523	8/33	11.56	Shtet
60	ELBASAN	GËZIM	ISLAM	BRAHJA	1082, 4475	8523	29/296	141.8	Shtet
61	ELBASAN	TAULANT	VANGJEL	DEDJA	478, 5636	8524	2/629	12.6	Shtet
62	ELBASAN	FLARENT	FATMIR	CËRRIKU	410, 3105	8525	7/415	269.1	Shtet
63	ELBASAN	BEKHET	JEMIN	CËRRIKU	415, 7168	8525	15/141	119.7	Shtet
64	ELBASAN	SERVET	MUSA	TANUSHI	45	2654	1157/1	500	Shtet
65	ELBASAN	ILIR	MUSA	TANUSHI					
66	ELBASAN	NURI	AOOIF	DISHA	375, 9394	2448	207/1	315	Shtet



57	ELBASAN	SKËNDER	ABEDIN	BLLOSHMI	277	1063	506/1	360	Shtet
58	ELBASAN	SPIRO	ZENEL	TOTA	5744	1527	260/1/1	217.2	Shtet
59	ELBASAN	VASIL	MAKSUT	MURAÇI	4696	1527	260/3	341.1	Shtet
60	ELBASAN	BAJRAM	HAQIF	GJOKOLA	8048	2351	1278/1	300	Shtet
61	ELBASAN	GURALI	AVNI	TORRA	1079, 11757	2924	1/485	170.6	Shtet
62	ELBASAN	BLENDAR	DERVISH	DEDJA	6171	2924	5/518	175	Shtet
		ERKEL	DERVISH	DEDJA					
63	ELBASAN	BEDRI	HAXHI	LAÇKA	133, 14306	3203	1106/1	282.9	Shtet
64	ELBASAN	FERDINANT	RIZA	DERVISHI	103/3	2116	413/1	173	Prone e vet + Shtet
65	ELBASAN	VASE	XHEMAL	FACJA	1461, 4711	3683	139/1	468	Shtet
		BENI	RAMIS	FACJA					
66	ELBASAN	THANAS	SELIM	ALLIU	8483	3120	67/101	472.5	Shtet
67	ELBASAN	MUHAMET	SHEFKI	KUSHITA	21836	3120	82/100	189	Shtet
68	ELBASAN	HALIT	HAJDAR	FEÇI	14109	3120	200/100	270.9	Shtet
69	ELBASAN	DRITAN	FERIT	BELBA	6494	3468	238/100	440.7	Shtet
70	ELBASAN	HAXHI	SABRI	BELBA	21158	3468	357/7/1	236.1	Shtet
71	ELBASAN	GAZMOR	ISUF	RRUSHI	21990	1905	179/1	500	Shtet
72	ELBASAN	KLEDI	ISUF	RRUSHI	21989	1905	180/1	282.3	Shtet
		ALEKS	ISUF	RRUSHI					
73	ELBASAN	KAMER	NUREDIN	VASKO	11748	2096	113/1/1	346.8	Shtet
74	ELBASAN	ARMAND	XHEMAL	SULA	21830	2096	170/100	259.8	Shtet
75	ELBASAN	MEXHIT	GANI	BENXHAJ	9143	1546	283/100	305.7	Shtet
76	ELBASAN	AFRIM	SEFER	DYBELI	1061, 15381	8522	13/246/1	88.75	Prona + Shtet
		MANUSHAQE	SHEFQET	DYBELI					
77	ELBASAN	IRENA	BEQIR	ELEZI	237	8523	17/354	499.3	Shtet
78	ELBASAN	YLLI	KADRI	SALLA	131	2654	619/1	167.7	Shtet
79	ELBASAN	ISA	ALI	HYKA	625	3965	941/2	2995.4	Prona + Shtet
80	ELBASAN	ISA	ALI	HYKA	624, 780	3965	941/3	656.5	Prona + Shtet
81	FIER	MIHAL	TUNI	KOLA	12455	8533	10/1047	500	Shtet
82	FIER	MUHAMREM PANDELI RAMI	QANI THEMI ASQERI	MYRDINI MONE SKENDAJ	28	8534	3/554	60	Shtet
83	FIER	GAETANO	ASQERI	GERGALI	167	3934	50/605	186	SHTET
84	FIER	SHABAN	FERHAT	REKAJ	392	3934	50/606	284	SHTET
85	FIER	TEKI	IBRAHIM	GERGALI	288	3934	50/611	217	SHTET
86	FIER	RAMADAN	TAJAR	KANANI	1527	3934	50/612	230	SHTET
87	FIER	BASHKIM	JONUS	LILLO	23952	3934	51/707	71	SHTET
88	FIER	ZENEL	BEKTASH	GREMI	24813	3934	57/612	306	SHTET
89	FIER	FASLLI	HYSEN	HODAJ	399	3934	110/502	361	SHTET
90	FIER	KUDRET	ISUF	HOXHAI	877	3934	110/508	500	SHTET
91	FIER	GYZDAR	MURAT	DURAJ	851/1	3934	123/500	357	SHTET
92	FIER	ARTUR	LUTO	AVDO	405	3934	280/910	357	SHTET
93	FIER	SOKOL	LUTO	AVDO	541	3934	280/911	321	SHTET
94	FIER	LUTO	NEIM	AVDO	418	3934	280/912	390	SHTET
95	FIER	XHEVDET	DERVISH	BRAKAJ	166	3934	280/913	321	SHTET+PRONAR
96	FIER	KODHEL	MUHAMET	ALIU	381	3934	280/915	468	PRONAR
97	FIER	NESTI	RAKIP	HYSENAJ	535	3934	280/922	283	PRONAR
98	FIER	SAMI	NURI	ARAPI	520	3934	289/610	380	SHTET
99	FIER	SHKELZEN	IDRIZ	MAVRIQI	7944	3934	292/600	56	SHTET
100	GJIROKASTER	MIRELA	THODHORI	PAGUNA	21	2484	92/43	191.0	Shtet
101	GJIROKASTER	STAVRULLA	NIKOLLA	KURTESI	1037	2484	91/4	318.0	Shtet
102	GJIROKASTER	PANOREA	NIKOLLA	ZISI	1007	2484	91/3	262.5	Shtet
103	GJIROKASTER	VASIL	THANAS	MERXHANI	26	2484	178/1	225.0	Shtet
104	GJIROKASTER	RESUL	ABEDIN	BRAHIMI	35	2392	3945	225	Shtet
105	GJIROKASTER	BACE	SHAQO	GJYLI	903	2392	3947	500	Shtet
106	GJIROKASTER	LINDITA	ALI	KASMAHU	574	2392	3948	300	Shtet
107	GJIROKASTER	LUMTURI, ARLIND	MUHO,DAUT	RABAJ	531	2392	3951	177.8	Shtet
108	GJIROKASTER	MUHAREM	METO	HALLAÇI	215	2392	3952	500	Shtet
109	GJIROKASTER	RAMADAN	JONUS	SHEHU	2655	8543	24/142	55	Shtet
110	GJIROKASTER	RAMADAN	JONUS	SHEHU			24/144	67.5	Shtet
111	GJIROKASTER	VASILIQI	GRIGOR	ZOKO	271	2483	501/49	40.0	Shtet
112	GJIROKASTER	VASIL	JORGO	BARKA	474	1234	9/95	48.0	Shtet
113	GJIROKASTER	GLIGOR	KOÇO	BARKA	310	1234	11/54	390.0	Shtet
114	GJIROKASTER	JORGO	ILIA	MASTORA	2244	1234	113/10	265.0	Shtet
115	GJIROKASTER	HARALLAMB	NIKOLLA	NIKA	1311	1234	26/103	300.0	Shtet
116	GJIROKASTER	VIKTORIA	PANAJOT	LLOLI	1294	1234	26/102	500.0	Shtet
117	GJIROKASTER	MIHAL	JORGO	ILIA	961	1234	8/58	360.0	Shtet
118	GJIROKASTER	DHIMOKRAT	VASIL	KOLO	180	3833	28/16	347.0	Shtet
119	GJIROKASTER	KOSTANDIN	MILTO	HIDO	606	1484	368/274	226.0	Shtet
120	GJIROKASTER	ARBEN	SPIRO	KURO	632	1484	368/275	278.0	Shtet
121	GJIROKASTER	JULJAN	SALI	KALEMI	43	1336	3/1	1,520.0	Shtet
122	GJIROKASTER	ASQERI	SKENDER	ZACE	11	3719	297/63	167.0	Shtet
123	GJIROKASTER	PETRI	METO	META	308	2646	5/453	41.3	Shtet
124	GJIROKASTER	PËRPARIM	RIZA	PATA	208	3574	15/305	132.0	Shtet
125	GJIROKASTER	EQEREM	SABRI	XHAFA	227	3574	22/80	128.0	Shtet
126	GJIROKASTER	VENO	KALO	XHAFA	251	3574	22/81	110.0	Shtet
127	GJIROKASTER	JORGJL,PETRO	ILIA	BASHO	105	1023	365/165	309.0	Shtet
128	GJIROKASTER	OSMAN	ADEM	TOLA	22	3421	282/7	263.0	Shtet
129	GJIROKASTER	ROLAND	FOTO	SULI	97	2646	4/204	110.7	Shtet
130	GJIROKASTER	SKENDO	KADRI	SINA	1230	2647	181/111	300	Shtet



131	GJIROKASTËR	ALI	MERKO	KUÇAJ	1092	3574	12/197	62.7	Shtet
132	GJIROKASTËR	JASHAR	MEHMET	HOXHA	156	3574	13/315	18	Shtet
133	GJIROKASTËR	BESNIK	ZAİM	ABAZI	159	2173	53/44	190	Shtet
134	GJIROKASTËR	ARSHI	FEİM	HOXHA	2221	1130	131/10	2095	Shtet
135	GJIROKASTËR	ARJAN	LAME	ÇELA	212	3574	22/77	120	Shtet
136	GJIROKASTËR	PERIKLI, BEHO	TEME, ABEDIN	DALANI	550	3574	4/81	59.5	Shtet
137	GJIROKASTËR	BILBİL	QEMAL	MANAJ	1026	3574	4/82	480	Shtet
138	GJIROKASTËR	DULE	SALI	BISHA	2197	1529	347/1	340	Shtet
139	TIRANA 3	SOKOL	NOVRUS	LAMA	1475	3865	292/32/10	417	SHTET
140	TIRANA 3	ALFRED	NOVRUS	LAMA					
141	TIRANA 3	SKENDER	SELMAN	GUJZI	3150	1170	122/51	327.3	PA INFO
142	TIRANA 3	FEMI	HAMIT	PISLI	141	3550	141/301	250.8	SHTET
143	TIRANA 3	EDUART	MUHAMED	BITRI	2	2679	54/196	361.8	TE TRETVE
144	TIRANA 3	PULLUMB	YMER	REKA	367	2952	50/201	370.2	SHTET
145	TIRANA 3	DURIM	SAID	NASUFI	2219	1170	60/15/1	360	SHTET
146	TIRANA 3	SHPETIM	UK	MURATAJ	1274/1	2679	53/239/2	372	SHTET
147	TIRANA 3	ARJAN	ANDREA	STERJO	1062	3972	54/3101	297	SHTET
148	TIRANA 3	ZAMIR	RIZA	SULA	15458	1977	229/1/28	291	SHTET+TE TRETVE
149	TIRANA 3	MENTOR	SKENDER	KULLOLLI	2869	2704	404/1527	255.6	TE TRETVE
150	TIRANA 3	RAMADAN	SHEFQET	MYFTARAJ	1518	1605	340/9112	390	PA INFO
151	TIRANA 3	HYDRI	ISLAM	SPAHO	19469	3292	590/1004	144	SHTET+PA INFO
152	TIRANA 3	ENVER	AGIM	HASMUCA	1119	3471	2754/20	331.2	SHTET
153	TIRANA 3	GEZIM	AHMET	DEDA	14/1	3471	275/4/15	319.5	SHTET
154	TIRANA 3	FRAN	KOLE	DELIA	523	2380	83/589	336.5	SHTET
155	TIRANA 3	GEZIM	KOL	DELIA	625	2380	580/1015	278	SHTET
156	TIRANA 3	XHEMAL	ABAZ	KAMBERI	898/1	2539	279/1	328.5	SHTET
157	TIRANA 3	SELIM	AHMET	LLESHI	349	1605	211/8/20	237.9	SHTET
158	TIRANA 3	BESIM	QAZIM	DERVISHI	319	2380	80/245	347.1	SHTET
159	TIRANA 3	ASLLAN	MEHMET	SALLAKU	476	1170	103/1017	339	TE TRETVE
160	TIRANA 3	MURAT	ASLLAN	MUJA	15582	1170	78/111	270.3	SHTET+PA INFO
161	TIRANA 3	FERIT	HYSEN	META	714	1170	68/100	318	SHTET
162	TIRANA 3	LULZIM	SALI	ÇAKRI	724	1170	114/12	298.5	SHTET+TE TRETVE
163	TIRANA 3	MUSA	ADEM	DUKA	2746	2690	60/7	263.1	PA INFO
164	TIRANA 3	DYLBER	RAMAZAN	SALLAKU	754	1977	200/85	301.5	PA INFO
165	TIRANA 3	MERXHAN	NAİM	POTI	5607	2704	515/50	186	SHTET
166	TIRANA 3	NAİM, ARTAN	SHEMST, NAİM	POTI, POTI	1772	2704	515/30/1	300.9	SHTET
167	TIRANA 3	MIRVETE	XHAVIT	BARDEHI	1656	1605	350/2917	394	TE TRETVE
168	TIRANA 3	DILAVER	HAKI	POTI	1875	2704	515/40	393.1	SHTET
169	TIRANA 3	FLORIAN	SHKELQIM	BETI	52	2704	590/1012/1	378	TE TRETVE
170	TIRANA 3	QERIM	JAKUP	BIBA	1620	1605	350/21/20	305.4	SHTET
171	TIRANA 3	ISMAIL, HALIM	HALIM, ISMAIL	SEFERI	2018	1605	340/100	500	TE TRETVE
172	TIRANA 3	LUAN	MUHAMMAD	PALUSHI	2597	1605	590/1013	360	TE TRETVE
173	TIRANA 3	XHEMALI	XHEMAL	SEFERI	9,072,061	1605	590/1000	306	TE TRETVE
174	TIRANA 3	ARTAN	HILMI	PALUSHI	2530	1605	350/15/5	352.2	TE TRETVE
175	TIRANA 3	RAMIZ	ISMAIL	MANAJ	367	3550	165/65	270.3	TE TRETVE
176	TIRANA 3	NUSRET	MAKSUT	HAFUZI	2751, 3412	1604	512/80/1	271	TE TRETVE
177	TIRANA 3	NESIBI	ISA	BAKALLI	1511	2529	340/9/1	255	SHTET
178	TIRANA 3	AGRON	MAKSUT	PALUSHI	2644	1605	350/21/1	376.2	SHTET
179	TIRANA 3	ASTRIT	ABDYL	SHEHU	1287	1605	359/3	432	SHTET
180	TIRANA 3	SEHAT	NESHAT	LLUKOVI	2673	2704	984/27/1	265.2	TE TRETVE
181	TIRANA 3	BAFTJAR	MUSTAFA	BETI	3393	2704	590/1003	383	TE TRETVE
182	TIRANA 3	LEONARD	TAHIR	GJONI	3415	2704	606/135	339	TE TRETVE
183	TIRANA 3	SHERIF	ENVER	AHMETAJ	3308	1605	350/87	352.9	SHTET
184	TIRANA 3	DYLAMAN	QAMIL	MYFTARAJ	1514	1605	402/1685	393	PA INFO
185	TIRANA 3	MARIJUS	BEHAR	MEMAGA	3265	2947	373/5	249.6	SHTET
186	TIRANA 3	NURIJE	HAJRULLA	VOGLI	4230	2529	224/10/3	436.5	SHTET+PA INFO
VKM 100, datë 27.1.2009	C	DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8513	1
8		ELBASAN	Q. ELBASAN, Z.K. 8526	2
9		ELBASAN	Q. ELBASAN, Z.K. 8527	2
10		Totali për VKM 100, datë 27.1.2009		5
VKM 167, datë 19.2.2009	D	DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8517	4
11		Totali për VKM 167, datë 19.2.2009		4
VKM 286, datë 18.3.2009	E	ELBASAN	Q. ELBASAN, Z.K. 8527	1
12		Totali për VKM 286, datë 18.3.2009		1
VKM 450, datë 6.5.2009	F	ELBASAN	Q. ELBASAN, Z.K. 8527	1
13		TIRANA 1	Q. TIRANË, Z.K. 8190	1
14		DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8511	4
15		TOTALI për VKM 450, datë 6.05.2009		6
VKM 611, datë 11.6.2009	G	DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8511	5
16		DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8517	1
17		LUSHNJE	Q. Fier, B. Lushnje, Z.K. 8572	1
18		TIRANA 1	Q. TIRANË, Z.K. 8190	1
19		Totali për VKM 611, datë 11.6.2009		8
VKM 677, datë 18.6.2009	H	DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8515	1
20		ELBASAN	Q. ELBASAN, Z.K. 8525	1
21		TIRANA 1	Q. TIRANË, Z.K. 8310	1
22		TIRANA 1	Q. TIRANË, Z.K. 8210	1
23		TOTALI për VKM 677, datë 18.6.2009		4
VKM 706, datë 23.6.2009	I	TIRANA 1	Q. TIRANË, Z.K. 3416	1
24		Totali për VKM 706, datë 23.06.2009		1
VKM 805, datë 22.7.2009	J	DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8517	2
25		DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8511	1
26		Totali për VKM 805, datë 22.7.2009		3
VKM 1038, datë 14.10.2009	K	TIRANA 1	Q. TIRANË, Z.K. 8320	7
27		Totali për VKM 1038, datë 14.10.2009		7
VKM 1134, datë 18.11.2009	L	DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8515	2
28		Totali për VKM 1134, datë 18.11.2009		2
VKM 1283, datë 23.12.2009	M	DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8515	3
29		Totali për VKM 1283, datë 23.12.2009		3



VKM 125, datë 17.2.2010				
30		ELBASAN	Q. ELBASAN, Z.K. 1842	1
31		FIER	Q. FIER, Z.K. 3934	1
32		TIRANA 1	Q. TIRANË, Z.K. 8330	1
33		TIRANA 2	Q. TIRANË, Z.K. 8260	1
	N	VKM 125, datë 17.2.2010		4
VKM 247, datë 13.4.2010				
34		DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8517	1
35		DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8515	1
	O	Totali për VKM 247, datë 13.4.2010		2
VKM 404, datë 26.5.2010				
36		DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8518	3
37		ELBASAN	Q. ELBASAN, Z.K. 8525	1
	P	Totali për VKM 404, datë 26.5.2010		4
VKM 549, datë 7.7.2010				
38		DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8517	1
39		DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8511	1
	Q	Totali për VKM 549, datë 7.7.2010		2
VKM 646, datë 28.7.2010				
40		ELBASAN	Q. ELBASAN, Z.K. 8525	1
41		ELBASAN	Q. ELBASAN, Z.K. 8523	1
42		LUSHNJE	Q. Fier, B. Lushnje, Z.K. 8572	1
43		DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8518	1
44		DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8511	2
45		TIRANA 1	Q. TIRANË, Z.K. 8320	8
46		TIRANA 1	Q. TIRANË, Z.K. 8110	2
47		TIRANA 1	Q. TIRANË, Z.K. 2679	1
48		TIRANA 2	Q. TIRANË, Z.K. 8320	1
	R	Totali për VKM 646, datë 28.7.2010		18
VKM 118, datë 17.2.2011				
49		DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8511	2
50		ELBASAN	Q. ELBASAN, Z.K. 3422	1
51		LEZHË	Q. Lezhë, Z.K. 8632	1
52		LEZHË	Q. Lezhë, Z.K. 2180	1
53		BERAT	Q. BERAT, Z.K. 2310	1
54		FIER	Q. FIER, Z.K. 8534	1
55		FIER	Q. FIER, Z.K. 8533	2
56		FIER	Q. FIER, Z.K. 8531	1
57		FIER	Q. FIER, Z.K. 8571	1
	S	Totali për VKM 118, datë 17.2.2011		11
VKM 359, datë 4.5.2011				
58		DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8518	2
59		DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8511	1
60		TIRANA 2	Q. TIRANË, Z.K. 8260	1
	T	Totali për VKM 359, datë 4.5.2011		4
VKM 822, datë 23.11.2011				
61		DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8513	2
62		DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8511	1
	U	Totali për VKM 822, datë 23.11.2011		3
VKM 513, datë 1.8.2012				
63		DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8518	1
64		SHKODËR	Q. SHKODËR, Z.K. 8594	1
	V	Totali për VKM 513, datë 1.8.2012		2
VKM 345, datë 24.04.2013				
65		DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 8511	1
66		ELBASAN	Q. ELBASAN, Z.K. 2124	1
67		LISHNJE	Q. TIRANË, Z.K. 8572	1
68		KUKËS	Q. KUKËS, Z.K. 2602	3
	AA	Totali për VKM, datë 24.4.2013		6
VKM 501, datë 10.6.2015				
69		TIRANA 2	Q. TIRANË, Z.K. 8270	1
	AG	Totali për VKM 501, datë 10.6.2015		1
VKM 42, datë 21.1.2015				



70	AH	FIER	Q. FIER, Z.K. 3981	2
71		FIER	Q. FIER, Z.K. 1414	2
72		FIER	Q. FIER, Z.K. 3934	1
73		FIER	Q. FIER, Z.K. 1471	1
74		FIER	Q. FIER, Z.K. 2636	1
Totali për VKM 42, datë 21.1.2015			7	
VKM 279, datë 1.4.2015				
75	AI	TIRANA 2	Q. TIRANË, Z.K. 8180	1
Totali për VKM 279, datë 1.4.2015			1	
VKM 474, datë 3.6.2015				
76	AJ	LEZHË	Q. LEZHË, Z. K. 8632	1
77		KORÇE	Q. KORÇË, Z.K. 8563	1
78		FIER	Q. FIER, Z.K. 3532	1
Totali për VKM 474, datë 3.6.2015			3	
VKM 615, datë 7.7.2015				
79	AK	DURRËS	Q. Durrës, Z.K. 1574	1
Totali për VKM 615, datë 7.7.2015			1	
VKM 669, datë 29.7.2015				
80	AL	SHKODËR	Q. SHKODËR, Z.K. 8593	1
Totali për VKM 669, datë 29.07.2015			1	
VKM 823, datë 7.10.2015				
81	AM	LEZHË	Q. LEZHË, Z.K. 1987	9
82		LEZHË	Q. LEZHË, Z.K. 8631	1
83		LEZHË	Q. LEZHË, Z.K. 3126	1
84		LEZHË	Q. LEZHË, Z.K. 2886	1
Totali për VKM 823, datë 07.10.2015			12	
VKM 882, datë 30.10.2015				
85	AN	GJIROKASTËR	Q. GJIROKASTËR, Z.K. 8543	1
86		LEZHË	Q. LEZHË, Z.K. 2569	5
87		SHKODËR	Q. SHKODËR, Z.K. 1799	1
Totali për VKM 882, datë 30.10.2015			7	
TOTALI PËRFUNDIMTAR				147

VENDIM**Nr. 449, datë 15.6.2016**

**PËR MIRATIMIN E KUSHTEVE DHE
TË PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN
E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË
FUNDIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 87, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. Të përgjithshme**

1. Ky vendim përcakton kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike. Kjo procedurë zbatohet nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese.

2. Furnizuesi i mundësisë së fundit, i caktuar nga ERE, është i detyruar të furnizojë klientët, të cilët mbeten pa furnizues, kur:

a) furnizuesi i mëparshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi, është në kushtet e paafësisë paguese ose është në proces falimentimi;

b) furnizuesit të mëparshëm, në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i është hequr ose i është pezulluar përko-hësisht licenca;

c) klienti e ka objektivisht të pamundur të gjejë një furnizues në treg.

3. Në këtë vendim, termi “aplikues” nënkupton një furnizues, i cili, në përputhje me këtë vendim, aplikon për të qenë furnizues i mundësisë së fundit. Çdo përdorim tjetër, në këtë vendim, do të ketë kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

II. Kushtet dhe procedurat për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit

1. Shoqëritë e interesuara për t’u caktuar si furnizues të mundësisë së fundit kanë të drejtë të aplikojnë në ERE, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e vendimit të Bordit të Komisionerëve për hapjen e procedurës.



2. Aplikuesi, për t'u caktuar si furnizues i mundësisë së fundit, duhet të dorëzojë dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Ekstraktin e regjistrit tregtar, nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;

b) Kopje të licencës për furnizimin me energji elektrike në Republikën e Shqipërisë;

c) Përshkrimin e kapaciteteve teknike, organizative, profesionale dhe financiare të shoqërisë;

ç) Dëshmi të nevojshme që shoqëria shet dhe blen energji elektrike nëpërmjet transaksioneve (dypalëshe) në baza javore;

d) Dokumente që vërtetojnë se personi juridik i ka plotësuar detyrimet fiskale dhe të sigurimeve shoqërore, lëshuar nga administrata tatimore;

dh) Dokumentin që vërteton se personi juridik nuk është dënuar me vendim të formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e shoqërisë, lëshuar nga gjykata;

e) Dokumentin që vërteton se përfaqësuesi i personit juridik nuk ndodhet në ndjekje penale, lëshuar nga prokuroria;

ë) Informacion të detajuar për aktivitetin e tij, bazuar në kërkesat e përgjithshme, të specifikuara në këtë vendim, dhe, veçanërisht:

i) eksperiencën e tij të mëparshme në aktivitetin e furnizimit dhe kategorinë e klientëve të furnizuar;

ii) datën kur është i gatshëm për fillimin e ushtrimit të funksioneve të furnizuesit të mundësisë së fundit.

3. Në vendimin për hapjen e procedurave ERE miraton kriteret e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit, duke përcaktuar pikëzimin mbi elementet e kapaciteteve teknike, organizative, profesionale, financiare dhe eksperiencën e shoqërisë së furnizimit.

4. ERE shqyrton nëse dokumentet e depozituara nga aplikuesi janë në përputhje me kërkesat e këtij vendimi dhe mund të kërkojë dokumentacion shtesë për të verifikuar besueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave të dokumenteve.

5. Në rastet kur në aplikim mungon ndonjë nga dokumentet ose informacionet e kërkuara, ERE i kërkon aplikuesit të paraqesë dokumentacionin e munguar, brenda 7 ditëve kalendarike nga dita e njoftimit për plotësimin e tij.

6. Bordi i Komisionerëve të ERE-s, brenda 30 ditëve kalendarike nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 2, të këtij kreu, cakton si furnizues të mundësisë së fundit aplikuesin me

pikët më të larta, që zotëron aftësitë më të mirat për të kryer detyrimet e furnizuesit të mundësisë së fundit dhe angazhohet dhe për të kryer detyrat sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

7. ERE, në vendimin e caktimit të furnizuesit të mundësisë së fundit, përcakton detyrimet ligjore për aktivitetet e furnizuesit të mundësisë së fundit dhe të drejtat e detyrimet e tij.

8. Furnizuesi i përzgjedhur i mundësisë të fundit duhet të konsiderohet si personi i caktuar për të siguruar furnizimin e mundësisë së fundit me energji elektrike për konsumatorët familjarë dhe konsumatorët e vegjël jofamiljarë, sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 86, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë 3-vjeçare, nga momenti i përzgjedhjes.

9. Furnizuesi i mundësisë të fundit, pas miratimit të vendimit të ERE-s, duhet të publikojë në faqen e tij të internetit një njoftim mbi mundësinë e furnizimit me energji elektrike si mundësi e fundit dhe duhet të njoftojë operatorët e sistemit të transmetimit e të shpërndarjes për fillimin e punimeve si furnizues i mundësisë të fundit.

10. Furnizuesi i mundësisë së fundit duhet të përmbushë detyrimet sipas ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, kodet e sistemit të transmetimit e të shpërndarjes dhe çdo akt tjetër të nevojshëm për funksionimin e tij.

11. Furnizuesi i mundësisë së fundit duhet të informojë ERE-n për përfundimin e afatit të caktimit të tij në përputhje me afatet ligjore, por jo më vonë se 4 (katër) muaj më përpara.

12. ERE, në përputhje me ligjin nr. 43/2015, monitoron dhe mbikëqyr aktivitetin e furnizuesit të mundësisë të fundit.

III. Përfundimtare

1. Deri në përzgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit, sipas këtij vendimi, ERE cakton, përkohësisht, furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për të kryer detyrat e furnizuesit të mundësisë së fundit.

2. Në rastet kur klienti nuk arrin të sigurojë furnizues në treg, për shkak të pamundësisë objektive të operatorëve të sistemit, furnizimi si mundësi e fundit kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit.



3. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Enti Rregullator i Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 450, datë 15.6.2016

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË
ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË
“NXITJA E BIZNESIT SOCIAL” SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 20, të statutit të shoqërisë “Nxitja e biznesit social” sh.a., miratuar me vendimin nr. 391, datë 1.6.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të shoqërisë “Nxitja e biznesit social” sh.a”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. En Muçi emërohet administrator i shoqërisë “Nxitja e biznesit social” sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 451, datë 15.6.2016

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI,
NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR TE
BASHKIA POLIÇAN, TË QENDRËS
POLIVALENTE PËR SHËRBIME TË
PËRKUJDESHIT SHOQËROR, DHE PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.
1324, DATË 1.10.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË
SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR, TË
NDËRTESES SË ISH-SPITALIT,
POLIÇAN, DHE NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 60, DATË 1.2.2006, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT**

**TË PRONAVE SHTETËRORE, TË CILAT
I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT
SOCIAL SHTETËROR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, shkronja “d”, 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi, nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror te Bashkia Poliçan, të pronës me nr. 32, me emërtimin “Qendra Polivalente për Shërbime të Përkujdesit Shoqëror”, sipas formularit dhe planimetrisë bashkëlidhur, për t’u përdorur për shërbime të përkujdesit social për kategoritë në nevojë.

2. Bashkisë Poliçan i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

3. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave shtetërore, miratuar me vendimin nr. 1324, datë 1.10.2008, të Këshillit të Ministrave.

4. Institucioni, i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, dhe shërbimi shoqëror që ofrohet, transferohen bashkë me ndërtesën, fondet, pajisjet, inventarin, personelin dhe dokumentacionin përkatës.

5. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e grupit 25, titulli 10430, kap.1, artikulli 600, 601 dhe 602, të buxhetit të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, të miratuar për vitin 2016 dhe, në vijim, sipas vitit buxhetor përkatës.

6. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, kryetari i Bashkisë Poliçan dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



I.FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te vecanta)

Institucionii Pushtetit Qendror: Ministria e Mireqenies Sociale dhe Rinise


Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimit Sociale

Bashkia Poliçan

Sha e Perdorimit te Prones: **Sherbime Sociale**

Identifikoi ing: Oligert Dymishi
Supervizoi: Pashe Dervishi (specialist)
Aprovoi: Etleva Bisha (Drejtore 1 Pergjithshem)

A				B			C			
Zona Kadastrale & Indeksi I Hartes	Nr. Pasurise	Lloji I Prones	Emri I Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale e Nderteses	Funksioni per te cilin perdoret prona	Institucioni/ Enti me pergegjesi administrative	Institucioni/Enti perdores Statusi juridik I perdorimit	Te dhena te tjera	Shenime te vecanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
K 34-125		Truall ndertese	Qendra Polivalente per Sherbime te Perkujdesit Shoqeror Poliçan	3110m2	814m2	Sherbime per te moshuar	M.M.S.R	Drejt.Pergjith Sherbimit Social Shteteror	2 Ndertesa 2 kate dhe 4 katesh	



**VENDIM****Nr. 453, datë 15.6.2016****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI
I SEGMENTIT RRUGOR “BULQIZË-
URA E ÇERENEÇIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Bulqizë - Ura e Çereneçit”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “arë”, “truall”, “kultura bujqësore dhe drufrutorë”, me shumën e përgjithshme 1 164 648 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) lekë, nga të cilat:

- tokë “arë” dhe “truall”, me sipërfaqe 3 998 (tre mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë) m², me vlerë 489 310 (katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e treqind e dhjetë) lekë;

- “kultura bujqësore dhe drufrutorë”, me vlerë 675 338 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e treqind e tridhjetë e tetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë “arë”, “truall”, “kultura bujqësore dhe drufrutorë”, prej 1 164 648 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe

Infrastrukturës, zëri “Shpronësim”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar ZVRPP”, “Vërtetim hipotekor”, “Certifikatë pronësie”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Bulqizë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Bulqizë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Bulqizë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
"BULQIZË-URA E ÇERENEÇIT"

NR.	PRONARI		Z.Kad	Nr. i pasurisë	Lloji pas. Are			Lloji pas. Truall			Lloji pas. Kultura Bujq. Drufrutore	SHUMA LEKË	Shënime
					Sip.	Çmimi	Vlera	Sip.	Çmimi	Vlera			
	Emri	Mbiemri			Shpron. (m ²)	(leke/m ²)	(Lekë)	(m ²)	(Lekë)	(Lekë)			
1	Mustafa	Sula	3694	767/6	90	100	9000					9000	Konf. ZVRPP
2	Shkelqim	Gjini	1660	1	1284	100	128400					128400	Konf. ZVRPP
3	Rabie	Zeneli	1660	2	128	100	12800					12800	Konf. ZVRPP
4	Tahir	Kica	1660	130	98	100	9800					98100	Konf. ZVRPP
5	Tahir	Kica	1660	94	172	100	17200					17200	Konf. ZVRPP
6	Tahir	Kica	1660	95	83	100	8300					8300	Konf. ZVRPP
7	Tahir	Kica	1660	9	220	100	22000					22000	Konf. ZVRPP
8	Tahir	Kica	1660	50	233	100	23300					23300	Konf. ZVRPP
9	Mehdi	Kica	1660	51	132	100	13200					13200	Konf. ZVRPP
10	Esat	Kica	1660	69	64	100	6400					6400	Konf. ZVRPP
11	Lavdie	Disha	1660	1477	279	100	27900					27900	Konf. ZVRPP
12	Sinan	Alliu	1660	733	346	100	34600					34600	Konf. ZVRPP
13	Isuf	Bala	1660	735	454	100	45400					45400	Konf. ZVRPP
14	Agim	Kurcani	2262	111/13	245	100	24500					24500	Konf. ZVRPP
15	Dilaver	Mera	2262	29/3	170	100	17000				56170	73170	Konf. ZVRPP
16	Muharrem	Mera	2262	112/3							68565	68565	Konf. ZVRPP
17	Beqir	Dervishi	2262	38/1							550603	550603	Konf. ZVRPP
18	Ilir	Xhafa	1660	993/1				11	110	1210		1210	Konf. ZVRPP
												1164648	

URDHËR

Nr. 5091, datë 21.6.2016

PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TË APLIKIMIT DHE PROCEDURAVE PËR PËRFITIMIN E MBËSHTETJES FINANCIARE LIDHUR ME PROJEKTET PËR TURIZMIN

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 31, të ligjit nr. 93/2015, datë 27.7.2015, "Për turizmin", pikës 8 dhe 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 13.4.2016, "Për përcaktimin e kriterëve e të afateve të kërkesëpropozimeve për mbështetjen financiare të projekteve në fushën e turizmit",

URDHËROJ:

1. Miratimin e thirrjes për projekt propozime në fushën e turizmit, sipas formatit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Miratimin e formularit të aplikimit për fonde për përfitimin e mbështetjes financiare lidhur me projektet për turizmin, sipas formatit bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Miratimin e udhëzuesit për thirrjen për projekt propozime, sipas formatit bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Publikimin e procedurës për përfitimin e mbështetjes financiare, në lidhje me projektet për turizmin, në faqen zyrtare të MZHE-TS-së, në media, si dhe në Buletin e Njoftimeve Zyrtare.

5. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Turizmit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
Milva Ekonomi

THIRRJE PËR PROJEKT PROPOZIME NË FUSHËN E TURIZMIT

Një nga aspektet më kritike të turizmit në Shqipëri është sezoni turistik relativisht i shkurtër. Një turizëm i suksesshëm dhe kualitativ sigurisht varet nga tërheqja e tregut gjatë gjithë vitit. Natyrisht që ka përqendrim të turistëve gjatë sezonit veror, por Shqipëria ka nevojë të njihet si një destinacion për t'u vizituar, gjatë gjithë vitit. Qëllimi kryesor i kësaj thirrjeje është të forcojë



konkurrencën dhe qëndrueshmërinë e sektorit të turizmit në Shqipëri, duke inkurajuar zgjerimin e sezonit turistik nëpërmjet promovimit mediatik të produktit turistik vendas, duke diversifikuar produktin turistik me modele inovative, si dhe duke përmirësuar cilësinë e shërbimit nëpërmjet edukimit. Duke pasur parasysh këta objektiva kryesorë, thirrja e këtij viti është e ndarë në tri tematika:

1. Promovimi i atraksioneve turistike nëpërmjet aktiviteteve mediatike.

Nën këtë tematikë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes do të bashkëfinancojë projekte që do të synojnë:

- rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë që ka turizmi për zhvillimin e vendit dhe përfitimet e mundshme për popullsinë lokale të rajoneve të ndryshme;

- përfshirjen, gjithnjë e më shumë, në sektorin e turizmit të komuniteteve lokale;

- zhvillimin e marketingut të brendshëm, me synim lidhjen e industrisë së mikpritjes me industri të tjera lokale.

2. Zhvillimi dhe përmirësimi i produkteve turistike specifike, në përputhje me kërkesën

gjithnjë në rritje për paketa inovative, që ofrojnë përvoja të pazakonta me surpriza dhe ide stimuluese, përveç shërbimeve bazë standarde.

Nën këtë tematikë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes do të bashkëfinancojë projekte që do të synojnë:

- zhvillimin e produktit turistik në mënyrë inovative drejt produkteve të interesit të veçantë, me synim: argëtimin, shkëmbimin e eksperiencës dhe të të nxënit;

- zhvillimin e produktit turistik të kërkuar gjatë gjithë vitit, duke kontribuar kështu në diversifikimin e grupeve të synuara (aktivitete të ndryshme me tematikë etnografinë, trashëgiminë kulturore, gastronominë etj.).

3. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit në industrinë e mikpritjes, duke e konsideruar atë si reklamën më të mirë për cilësinë e turizmit në vend.

Nën këtë tematikë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes do të bashkëfinancojë projekte që do të synojnë:

- Formim profesional cilësor dhe krijimin e mundësive të nxënies së profesioneve të reja.



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ZHVILLIMIT
EKONOMIK, TURIZMIT
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

Thirrje për Projekt Propozime në fushën e Turizmit

FORMULAR PËR APLIKIM PËR FONDE

Pjesa I: Informacione të përgjithshme

Titulli i projektit: [Type text]

Aplikanti (emri i personit fizik/juridik që aplikon/partneri 1): [Type text]

Statusi ligjor i organizatës që aplikon: [Type text]

Numri i regjistrimit të organizatës që aplikon: [Type text]

Vendi i regjistrimit të organizatës që aplikon: [Type text]

Data e regjistrimit të organizatës që aplikon: [Type text]

Adresa: [Type text]

Faqja në internet: [Type text]

Personi i kontaktit: [Type text]

Pozita në organizatë: [Type text]

Tel: [Type text]

E-mail: [Type text]

Kohëzgjatja e projektit: nga data [Type text] deri në datën [Type text]

Vendi ose vendet e realizimit të projektit: [Type text]



Fusha dhe tema e projektit: [Type text]

Buxheti total: [Type text]

Fondet e kërkuara:

Pjesa II: Përshkrimi i projektit

Qëllimi i projektit: Përshkruani shkurtimisht projektin, problematikën që ai adreson, si dhe argumentimin se si projekti u përgjigjet nevojave të identifikuara (*maksimumi 10 rreshta*).

[Type text]

Objektivat e projektit (*maksimumi 5 rreshta për secilin objektiv*):

1. [Type text]

2. [Type text]

3. [Type text]

4. [Type text]

5. [Type text]

Lloji i aktiviteteve sipas fushës si dhe një përshkrim më i detajuar i aktiviteteve që janë planifikuar në çdo fushë (*maksimumi 5 rreshta për secilin aktivitet*):

1. [Type text]

2. [Type text]

3. [Type text]

4. [Type text]



5. [Type text]

A janë aktivitetet e propozuara të përshtatshme, praktike dhe në përputhshmëri me objektivat dhe rezultatet e pritura? *(Maksimumi 5 rreshta):*

[Type text]

A përmban projekti tregues objektivisht të verifikueshëm lidhur me rezultatet e aktiviteteve?
(Maksimumi 3 rreshta për secilin aktivitet):

Aktiviteti 1:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 2:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 3:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 4:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Aktiviteti 5:

Rezultatet e pritura dhe treguesit: [Type text]

Cili është grupi ose cilat janë grupet e synuara? *(Lutemi të përshkruani shkurtimisht, në mënyrë sa më të përmblodhur, se cili është grupi parësor i synimit të projektit dhe se si kanë për t'i shërbyer aktivitetet e projektit.)*

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Qëndrueshmëria e projektit – impakti afatgjatë i projektit nga pikëpamja e problematikës së adresuar, fushës së zhvillimit të projektit, si personit fizik/juridik që e propozon.

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Në konceptimin, hartimin dhe zbatimin e projektit, a është respektuar e drejta e autorit?



Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Pjesa III: Partnerët (nëse ka)

Bashkërendimi i punës midis partnerëve. (Përshkruani natyrën e partneritetit. Shpjegoni bashkërendimin e punës midis partnerëve duke përshkruar procesin e vendimmarrjes, si dhe funksionin dhe përgjegjësitë e secilit partner në zbatimin e projektit.)

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Partneri 1 (Aplikanti)

Misioni. Cili është misioni i subjektit tuaj?

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Struktura. Përshkruani strukturën e subjektit duke përfshirë detaje, si numrin e të punësuarve dhe strukturën e menaxhimit.

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Financimi. Si financohet subjekti juaj dhe cili ishte buxheti i tij për vitin paraardhës?

Maksimumi 5 rreshta: [Type text]

Partneri 2

Emri i personit fizik/juridik: [Type text]

Personi i kontaktit: [Type text]

E-mail: [Type text]

Adresa: [Type text]

Faqja në internet: [Type text]

**Pjesa IV: Buxheti**

Lutemi të përshkruani shpenzimet e përfshira për implementimin e projektit. Çfarë burimesh të fondeve të tjera janë të siguruara dhe të mundshme?

Lloji i shpenzimit	≠ e njësisë	Çmimi	TOTAL	Vetë aplikanti	Donatorët e tjerë -I-	Donatorët e tjerë -II-	MZHETTS
I. Shpenzimet direkte të projektit							
1.							
2.							
3.							
4.							
5.							
6.							
7.							
8.							
9.							
10.							
II. Shpenzimet administrative <i>(deri në 15% nga totali i kërkuar)</i>							
1.							
2.							



3.							
4.							
5.							
<i>Totali i shpenzimeve administrative:</i>							

TOTAL (edhe në %)¹:							
---------------------------------------	--	--	--	--	--	--	--

Vini re ! Në aplikimin e paraqitur nga subjektet aplikuese duhet të parashikohen edhe shpenzimet për auditimin e projektit.

¹ Ju lutemi të llogaritni shumën totale që mbulon çdo donator (duke përfshirë dhe MZHETTS dhe vetë aplikantin, qoftë ky individ apo organizatë), edhe si % e buxhetit total për projektin.



UDHËZUESI PËR THIRRJEN PËR PROJEKT-PROPOZIME PËR VITIN 2016

Fondi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për projektet do të mbështesë propozime të paraqitura nga persona fizike dhe juridikë, vendas ose të huaj, privatë apo publikë, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre turizmin.

Ky fond shkon për projekte që zhvillohen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Aktivitetet e propozuara duhet të përfundojnë brenda datës 31 Dhjetor 2016.

1. Kush mund të aplikojë?

a. Kriteret e pjesëmarrjes.

Subjektet pjesëmarrëse duhet të plotësojnë **kriteret e mëposhtme**:

Të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm lidhur me statusin e tyre juridik, provuar me ekstraktin e regjistrimit dhe ekstraktin historik, si subjekt, NUIS-in si dhe dokumentet që vërtetojnë se:

- 1) Nuk janë në proces falimentimi dhe se kapitalet e tij nuk janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;
- 2) Nuk janë subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe nuk ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga Gjykata, ose nuk ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;
- 3) Nuk janë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale si person juridik, ortak apo aksioner i shoqërisë;
- 4) Kanë përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;
- 5) Kanë përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës.

Të demonstrojnë që janë në gjendje të financojnë 100 % të të gjitha kostove të projektit të propozuar, përpara përfundimit të tij, provuar me kopje të certifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit, të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe raportet e auditit financiar, të certifikuara nga një subjekt i licensuar auditimi dhe kopje të deklaratave të xhiros vjetore.

Nëse aplikuesi është i huaj ai duhet të vërtetojë që i plotëson të gjitha kërkesat e renditura me sipër. Nëse dokumentet e sipërpërmendura nuk lëshohen në shtetin e origjinës, atëherë mjafton një deklaratë noteriale me shkrim nga ana e tij.

***b. Përveç formularit të plotësuar, a duhet të paraqes dokumente të tjera?***

Po. Nëse aplikoni si person fizik, lutemi të paraqitni një CV dhe një portofol të veprimtarisë tuaj. Nëse aplikoni si person juridik, lutemi të paraqitni një CV të subjektit, një portofol të veprimtarisë së tij të deritanishme.

Vini re ! I gjithë dokumentacioni duhet të jetë në tri kopje! Pas dorëzimit të dokumentacionit shoqërues të aplikimit, nuk është e mundur të tërhiqet dokumentacioni nga arkiva e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

2. Metoda e aplikimit

Shkarkoni formularin për “Thirrje për propozime”, të cilin mund ta gjeni më poshtë në formatin Word ose PDF. Më pas plotësojeni atë.

- Shkarko formularin docx
- Shkarko formularin pdf

Formulari i plotësuar dërgohet në adresën e emailit Erifili.Monka@ekonomia.gov.al
Orari: 08-16.30.

Sigurohuni që në “subject line” të e-mailit të jetë shkruar qartësisht emri i aplikantit dhe titulli i projektit, ashtu siç janë shkruar edhe në formularin e aplikimit.

Vini re ! Përveç formularit të plotësuar, në këtë adresë nuk duhet të dërgoni asnjë material tjetër!

Formulari i plotësuar, së bashku me dokumentacionin mbështetës referuar pikës **1. Kush mund të aplikojë?** duhet të dorëzohen në tre kopje pranë *Zyrës së Protokollit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në Adresën:*

Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit" Tiranë, Albania.

Sipër zarfit të shkruhet qartësisht:

Drejtuar : *Zyrës së Protokollit/Aplikim për projekte ; Emri i aplikantit; Titulli i projektit*

Në raste specifike mund t’ju kërkohet informacion/dokumentacion shtesë. Nga ana tjetër, nuk do të marrim në konsideratë asnjë informacion/dokumentacion shtesë që nuk ju është kërkuar.

Vini re ! *Në rastin kur aplikuesi është një subjekt, formulari duhet të mbajë firmën dhe vulën e subjektit.*

b. Kur mund të aplikoj?

Thirrja për projekt propozime në fushën e turizmit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes është hapur me datë 21/06/2016 dhe mbyllet me datë 20/07/2016 në përfundim të orarit zyrtar ora 16.30.

Vini re ! *Nuk do të pranohet asnjë aplikim që vjen pas këtij orari!*

c. Kur mund të fillojë projekti që kam propozuar dhe kur duhet të mbarojë?

Në përlllogaritjen e kohëzgjatjes së projektit konsideroni procesin e plotë të aplikimit deri në firmosjen e kontratës sipas afateve të përcaktuara. Për këtë thirrje, projektet fituese nuk mund të fillojnë para datës 01.09.2016 dhe duhet të përfundojnë deri më 31 Dhjetor 2016.

d. Sa zgjat procesi i vlerësimit?

Procesi i vlerësimit zgjat 30 ditë.

e. Cila është shuma për të cilën mund të aplikoj?

Për realizimin e projekteve fituese, skema e financimit do të mbulojë deri në 50% të kostove të pranuarra e të miratuara nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Projektet për të cilat do të kërkohet një financim që kalon 50% të fondit buxhetor vjetor të parashikuar në buxhetin e shtetit, miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave. Fondi në dispozicion për këtë thirrje për projekt-propozim është 21.000.000. Lekë. Financimi nga Buxheti i shtetit nuk mund të jepet më tepër se një herë në vit për të njëjtin subjekt konkurses.

h. Ku mund të kërkoj ndihmë në lidhje me aplikimin tim?

Për informacione të përgjithshme, kontaktoni në:

E- mail: Erifili.Monka@ekonomia.gov.al

3. Për çfarë mund të aplikoj?

Financohen dhe mbështeten projekte studimi, promovimi dhe edukimi apo modele inovative të produkteve turistike, në funksion të turizmit

4. Si do të vlerësohen kërkesat për financim dhe/ose mbështetje për projekte pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes?

Çdo propozim kalon nëpër dy faza të vlerësimit:

- vlerësimi i personit fizik/juridik;
- vlerësimi i projekt-propozimit (formulari i propozimit).

Në procesin e vlerësimit të personit fizik/juridik që paraqet kërkesën do të merren parasysh: profili dhe reputacioni i personit fizik/juridik dhe kapaciteti zbatues/menaxhues i tij; theksojmë se kriteret e mëposhtme nuk duhet të shkurajojnë organizata të reja, të cilat mund të përmbushin kriteret e tjera;

- veprimtaria e deritanishme dëshmon se personit fizik/juridik ka në objekt të veprimtarisë së tij/saj turizmin dhe fushat e lidhura me te.
- misioni i organizatës dhe objektivat e veprimtarisë së saj të deritanishme përputhen me politikat dhe strategjitë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
- personit fizik/juridik ka përvoja të suksesshme me partnerë e donatorë të tjerë;
- personit fizik/juridik ka treguar qëndrueshmëri dhe është rritur me kalimin e viteve;
- personit fizik/juridik ka kontribuar në fushën ku operon me produkte të rëndësishme;
- personit fizik/juridik ka kapacitetin në terma të burimeve njerëzore dhe ekspertizën teknike për të zbatuar/menaxhuar projektin.



Në procesin e vlerësimit të projekt-propozimit (formulari) do të merren parasysh:

- projekti i propozuar ka në objekt të veprimtarisë së tij turizmin dhe fushat e lidhura me të
- objektivat e projektit të propozuar përputhen me politikat dhe strategjitë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;
- problematika e identifikuar është aktuale dhe argumentimi i nevojës për projektin e propozuar është bindës;
- objektivat e projektit të propozuar përputhen me problematikën e identifikuar;
- origjinaliteti i projektit dhe cilësia e aktiviteteve të planifikuara;
- aktivitetet e planifikuara përputhen me objektivat e projektit dhe hapat e zbatimit të projektit janë të qarta;
- shpërndarja e resurseve dhe bashkërendimi i punës midis partnerëve janë efikas;
- treguesit e përzgjedhur për matjen e rezultateve të aktiviteteve të planifikuara janë të përshtatshëm;
- përpilimi i kostove financiare: kostot janë reale (çmimet janë të bazuara në referenca që aplikanti mund t'i argumentojë) dhe të justifikueshme (raporti kosto/rezultat është i pranueshëm);
- niveli i bashkëpunimit me persona fizikë/juridikë të tjerë, si dhe bashkëfinancimi i projektit
- qëndrueshmëria e projektit: sa afatgjatë është impakti i projekt-propozimit; nëse projekt-propozimi paraqet mundësi për rritjen profesionale të personit fizik /ngritjen e kapaciteteve të subjektit që aplikon, realizimin e projekteve të tjera në të njëjtën fushë ose adresimin e të njëjtës problematikë, zhvillimin e turizmit në Shqipëri;
- respektimi i të drejtës së autorit në të gjitha fazat – konceptim, hartim dhe zbatim – e projektit të propozuar.

Procesi i vlerësimit do të kryhet nga Komisioni i Përzgjedhjes së Projekteve në Turizëm i ngritur me Vendim të Këshillit të Ministrave posaçërisht për këtë qëllim.

d. Si duhet të veproj pasi kërkesa ime pranohet?

Nëse kërkesa juaj pranohet, 10 ditë pasi të jeni njoftuar për këtë, ju duhet të paraqiteni pranë Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes; për të proceduar me lidhjen e kontratës. Me lidhjen e kontratës dhe fillimin e projektit do të fillojë gjithashtu edhe procesi i monitorimit nga ana e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 476 lekë